Në bazë të kreut V të Nenit 29 të Statutit të "Federatës së Gjimnastikës së Kosovës'' Bordi i FGJK-së, aprovoi këtë:

RREGULLORE PËR REGJISTRIMIN E KLUBEVE, SHOQATAVE GJIMNASTIKORE, SI DHE TRANSFERET E GJIMNASTËVE/EVE

I. DIZPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Rregullorja për regjistrimin e klubeve, shoqatave të Gjimnastikës, Regjistrimi i gjimnastëve/eve, dhe levizjet e gjimnastëve i përcakton mënyrën, kushtet dhe çështjet e tjera që lidhen me regjistrimin e klubeve, shoqatave të gjimnastikës, regjistrimin e gjimnastëve/eve dhe transferimin (levizjet) e gjimnastëve/eve nga nje klub në një tjetër klub apo shoqatë gjimnastikore (në tekstin në vijim: klubet).

II. APLIKIMI I KLUBEVE, SHOQATAVE

Neni 2.

Federata e Gjimnastikës e Kosovës (në teksin e mëtejmë FGJK), vullnetarisht i përmbahet të njejtave kushte dhe përgjegjësive të të gjitha klubeve, shoqatave të gjimnastikës në përputhje me dispozitat e Statutit të FGJK-së, kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për anëtarësim në federatë janë:

2.1. Aplikimi duke plotësuar formularin për regjistrim në FGJK, klubit/shoqatës për dhe respektimin e Statutit dhe akteve tjera normative, ose me anë të kërkesës.
2.2. Të jetë e regjistruar në Minsitrinë e Administratës Publike, Departamenti për OJQ në Prishtinë/Kosovë si një OJQ sportive dhe posedon çertifikatën zyrtare të lëshuar nga ky institucion.
2.3. Gjatë aplikimit Klubi të sjell çertifikatën e OJQ dhe të Nr. Fiskal të noterizuar në FGJK.
2.4. Vendimi / Vërtetimi për regjistrim të klubit në Drejtorinë e Sportit pranë Kuvendit Komunal të një qyteti përkatës ku vepron dhe posedon një vendim të tillë nga organet kompetente komunale,
2.5. Emrat e personit/ve të autorizuar për përfaqësim në FGJK,
2.6. Çertifikatën e gjendjes penale, lëshuar nga gjykata, jo më të vjetër se 6 muaj,
2.7. Fletë konfirmimin e personit të autorizuar nga SEOJQ jo më të vjetër se 6 muaj,
2.8. Proces Verbali i Kuvendit të Klubit, me nenshkrim të Kryetari të Klubit ose Personit të Autorizuar.
2.9. Listën e anëtarëve të Kuvendit të Klubit, me 15 anëtarë (me nr. personal dhe nënshkrimet e tyre) dhe të vulosur dhe të nënshkruar nga Kryetari ose Personi i Autorizuar i Klubit,
2.10. Listën e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të Klubit prej tre anëtarëve, ***vërejtje: anëtarët e Këshillit Mbikqyrës nuk duhet të jenë anëtarë të Kuvendit të Klubit***, të vulosur dhe të nënshkruar nga Kryetari ose Personi i Autorizuar i Klubit,
2.11. Listën me emra të anëtarëve të Bordit të Klubit, (me nr. personal dhe nënshkrimet e tyre), të vulosur dhe të nënshkruar nga Kryetari ose Personi i Autorizuar i Klubit.

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, House of Sport, Rr – Str. "Agim Ramadani", 10000 Prishtinë, email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com, tel:+38344145009

2.12. Listën e sportistëve me nr personal të tyre, të vulosur dhe të nënshkruar nga Kryetari ose Personi i Autorizuar i Klubit,
2.13. Listën e trajnërëve me nr personal të tyre, të vulosur dhe të nënshkruar nga Kryetari ose Personi i Autorizuar i Klubit,
2.14. Statutin e Klubit, të vulosur dhe të nënshkruar nga Kryetari ose Personi i Autorizuar i Klubit, duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare në Republikën e Kosovës, dhe me Ligjin e Sportit Nr. **Nr. 08/L-277**,
2.15. Respektimi i Statutit dhe të gjitha akteve normative të FGJK-së.

III. PRANIMI DHE ZGJEDHJA

Neni 3.

Procedura për anëtarësimin e një klubi/shoqate dhe ndërprerja e anëtarësisë së klubit /shoqatës, përcaktohet sipas statutit të klubit/shoqatës, ose me një akt tjetër, në përputhje më nenin 6,7, 8,9,10,11,12 të Statutit të FGJK-së.

Neni 4.

Bordi Ekzekutiv rishikon raportin e komisionit për regjistrim për të gjitha aplikimet për anëtarësi dhe do rekomandon për pranim në Kuvendin e rregullt të punës , para fillimit të sezonit garues kalendarik.

4.1. Për anëtarët ekzistues aktiv, Bordi Ekzekutiv sipas raportit të komisionit për regjistrim e bënë konfirmimin e anëtarësisë. Ndërsa për anëtarët e rinj dhe anëtarët të cilët nuk e kanë paraqitur kërkesën për ripërtirjen e regjistrimit, Bordi Ekzekutiv sipas raportit të komisionit për regjistrim i paraqet rekomandimet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

4.2. Kuvendi me shumicën e votave të anëtarëve prezent me të drejtë vote merr vendim për rekomandimet e Bordit Ekzekutiv për regjistrime.

4.3. Në ditën e pranimit të anëtarësimit në FGJK, klubi regjistrohet në regjistrin e klubeve, shoqatave anëtare të FGJK-së.

4.4. FGJK, pas pranimit të kërkesës së klubit/shoqatës me dokumentacion të bashkangjitur, shkruan numrin dhe datën e pranimit në aplikacion dhe konfirmon me vule dhe nënshkrim të përsonit të autorizuar, jep informacionin e nevojshëm në librin e regjistrit, lëshon librëzat garuese, klubit i cili ka paraqitur kërkesë për regjistrim dhe atë më së largu 8 ditë, pas pranimit të kërkesës për regjistrim ose ri-regjistrim.

Neni 5.

Vazhdimi i regjistrimit (ri-regjistrimi), bëhet çdo vit dhe atë ekskluzivisht në periudhën prej 1 Janarit deri me 28 Shkurt të vitit aktual në FGJK.

5.1. Vazhdimi i regjistrimit (ri-regjistrimi), bëhet duke dërguar një kërkesë me shkrim tek Sekretari i FGJK-së, me një listë të gjimnastëve/eve aktual, dhe një listë të gjimnastëve/eve të rinjë.

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, House of Sport, Rr – Str. "Agim Ramadani", 10000 Prishtinë, email:
kosovagymnasticsfederation@gmail.com, tel:+38344145009

5.2. Kërkesa për vazhdimin e regjistrimit përbëhet nga një listë e gjimnastëve/eve për të cilët zgjatet regjistrimi, duke përfshi numrin e librezave për garues, si dhe datën dhe emrin e garave të fundit të vitit paraprak, që ata kanë marrë pjesë.

Neni 6.

FGJK, pas pranimit te kërkesës (aplikacionit) për vazhdim të regjistrimit, verifikon saktësinë e të dhënave të lartëpermendura më të dhënat në regjistrin e saj, dhe verifikon zgjatjen e regjistrimit me vulë dhe nënshkrim të personit të autorizuar në librezat garuese. Një kopje e aplikimit të vërtetuar i kthehet klubit kurse një kopje në dokumentacionin e FGJK-së.
Lista e verifikuar e gjimnastit/tes i shërben klubit si dëshmi e regjistrimit të duhur për sezonin e ardhshëm garues.

6.1. Një klub/shoqatë që nuk paraqet kërkes/aplikim me shkrim në kohën e duhur dhe nuk përmbush detyrimet e saj financiare në lidhje me këtë kosto, dhe nuk sjellë raportin mjekësor për garuesit e vetë nuk do të marrë libreza garuese, dhe se garuesit (gjimnastët/tet), nuk do të jenë në gjendjë të marrin pjesë në gara gjatë vitit kalendarik (kampionate rajonale apo kombëtare).

Neni 7.

Antarësia e Klubit dhe shoqatës në FGJK përfundon në përputhje më Nenin 10, të Statutit të FGJK-së.

7.1. Pas vlefshmëris së vendimit të Kuvendit për ndërprerjen e anëtarësisë në FGJK, klubi apo shoqata do të hiqet nga regjistri i Klubeve – shoqatave anëtare të FGJK-së.

IV. REGJISTRIMI I GJIMNASTËVE/EVE NË FGJK

Neni 8.

Gjimnasti/ja, anëtarësohet në FGJK në përputhje me e nenin 37, të Statutit të FGJK-së.

8.1. Gjimnasti/ja, ka të drejtë të paraqitet për një klub/shoqatë me kusht që të regjistrohet në FGJK si garues/e.

8.2. FGJK bënë regjistrimin e garuesve,

8.3. Garuesi nuk mund të regjistrohet njëkohësisht në dy ose më shume Klube/Shoqata.

Neni 9.

Klubi/shoqata e paraqet aplikimin në FGJK për regjistrimin e garuesve me të dhënat:

9.1. Aplikimi i regjistrimit (formulari i regjistrimit ipet nga FGJK),

9.2. Dy fotografi të madhësisë 20x30 mm,

9.3. Çertifikatë lindje (kopje për regjistrim të gjimnastëve),

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, House of Sport, Rr – Str. "Agim Ramadani", 10000 Prishtinë, email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com, tel:+38344145009

9.4. Raport mjekësor, (përshkruan gjendjen shëndetësore të gjimnastit/tes, jo më të vjetër se 3 muaj),

9.5. Një kopje nga klubi/shoqata e mëparshme, nëse është i/e regjistruar më parë në një klub/shoqatë tjetër,

9.6. Dokumentacion tjerër përcjellës nga i cili mund të shihet se regjistrimi mund të bëhet ligjërisht, dhe në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore.

VI. LIBREZA E GARUESVE

Neni 10.

Librezat e garuesve i shpërndanë (jep) FGJK-ja.

10.1. Me këtë librez, garuesi dëshmon se është i anëtarësuar dhe ka të drejtë të paraqitet dhe identifikoj vetën si garues në garë.

Neni 11.

Forma dhe përmbajtja e librezës së garuesit përcaktohet nga Bordi Ekzekutiv, ku një e tillë veç se është miratuar nga Bordi i FGJK-së, dhe se shuma për një librezë është 2.50 Euro.

Neni 12.

Me Librezën e garuesit në të cilën është vërtetuar regjistrimi, garuesi mund të konkurroj vetëm për një klub/shoqatë, për të cilën ai/ajo është i regjistruar në të gjitha fazat garuese.

VII. PROCEDURAT E TRANSFEREVE - LEVIZJEVE TË GJIMNASTËVE/EVE NGA NJË KLUB NË TJETRIN

Neni 13.

Lëvizja e garuesve (gjimnastëve/eve), nga një klub/shoqatë në tjetrin mund të kryhet ekskluzivisht dhe vetëm në periudhën kalimtare, e cila zgjat nga **01 deri në 31 Dhjetor të çdo viti.**

13.1. Përjashtimi nga paragrafi 1, i këtij Neni është periudha kalimtare për garuesit, kundër të cilëve kryhet një veprim disiplinor ose kur ka një masë disiplinore ndalimi. Afati i fundit është 8 (tetë) ditë nga përfundimi i pezullimit.

13.2. Regjistrimi i garuesve do të kryhet në përputhje më dispozitat e kësaj rregullore.

13.3. Një garues i regjistruar ka të drejtë të paraqitet për një klub/shoqatë të re në të gjitha garat brenda 24 orëve nga regjistrimi i tij/saj në FGJK.

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, House of Sport, Rr – Str. "Agim Ramadani", 10000 Prishtinë, email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com, tel:+38344145009

Neni 14.

Për garuesit e mitur, të cilëst dëshirojnë të ndryshojnë klubin/shoqatën mund ta bëjnë atë vetëm në afatet kalimtare të përcaktuara në këtë rregullore, duhet të paraqitet kërkesa nga përfaqësuesi ligjor (prindi ose kujdestari), dhe me nënshkrimim nga përfaqësuesi i garuesit, dhe personit të autorizuar i klubit/shoqatës, në të cilin ai/ajo dëshiron të kalojë, (Sekretari i Klubit, Kryetari etj).

14.1. Kërkesa i dërgohet me anë te postës së regjistruar ose përsonalisht shoqatës në postën elektronike të klubit/shoqatës, me konfirmimin e detyrueshëm të klubit/shoqatës se kërkesa është pranuar.

14.2. Një garues jo i mitur, kërkesën e dorëzon vetë, me nënshkrim të njërit nga prej personave të autorizuar të klubit/shoqatës në të cilën ai/ajo dëshiron të kalojë, në përputhje më procedurën e përcaktuar në paragrafin e lartë cekur.

14.3. Si datë për dorëzimin e kërkesës llogaritet data kur është vulosur kërkesa pas pranimit të kërkesës nga klubi/shoqata që ai/ajo dëshiron të kalojë.

14.4. Kërkesa që nuk dorëzohet me kohë dhe nuk është në përputhje më dispozitat e kësaj rregullore, nuk e detyron klubin/shoqatën që të merret me kërkesë.

Neni 15.

Nëse një garues, në përputhje më dispozitat e kësaj rregulloreje, nuk arrinë të regjistrohet për klub/shoqatë tjetër, konsiderohet të jetë një gjimnast/te i/e paregjistruar për vitin e ardhshëm ose vitin aktual garues dhe nuk mund të kryej asnjë garë në Kosovë ose jashtë saj.

Neni 16.

Kur në një periudhë kalimtare klubi/shoqata, merr një kërkesë për levizje të gjimnastëve/eve, ajo do t'i lirojë garuesit mbrenda 10 ditëve nga pranimi i kërkesës, me kusht që të plotësohen të gjitha kushtet për lirimin e përcaktuar me këtë rregullore.

16.1. Klubi/shoqata lëshon vendimin e vulosur dhe nënshkruar të organit të klubit/shoqatës të autorizuar nga statuti ose ndonjë akt tjetër të klubit/shoqatës.
Vendimi nënshkruhet nga Kryetari ose Sekretari i Klubit/shoqatës.

16.2. Klubi/shoqata mund të refuzojë të lëshoj vendim me arsyetim se garuesi/ja, ka detyrime financiare apo edhe tjera të paplotësuara në klub/shoqatë që janë të lidhura në bazë të marrëdhënjeve të tyre të ndërsjellta kontraktuese më anë të të cilave detyrimet e tilla të garuesit/sës janë vendosur me shkrim.

16.3. Për refuzimin e kërkesës, klubi/shoqata është e detyruar të informojë me shkrim aplikantët dhe Bordin Ekzekutiv të FGJK-së, duke deklaruar arsyet për refuzimin e aplikimit dhe dorëzimin e dokumentve që tregojnë qartë arsyet e refuzimit.

16.4. FGJK-ja nuk do të regjistrojë garuesin për një klub/shoqatë të ri deri sa të marrë dokumentacionin e vlefshëm mbi të cilin duhet të regjistrohet, dhe garuesi mbetet anëtar i klubit ku ai ka qenë.

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, House of Sport, Rr – Str. "Agim Ramadani", 10000 Prishtinë, email:
kosovagymnasticsfederation@gmail.com, tel:+38344145009

Neni 17.

Nëse klubi/shoqata nuk përgjigjet në kërkesës për transfer brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes/pranimit të kërkesës atëherë shkel dispozitat e këtyre rregullave, atëherë konsiderohet që kërkesa për transfer të gjimnastit/tës është eliminuar (nuk shkohet tutje).

Neni 18.

Rezultatet e arritura të garuesit nga dita e transferimit në klub/shoqatë të re, nuk mund të transferohen, regjistrohen si rezultat i klubit/shoqatës së re, për të cilën garuesi është regjistruar, dhe se nga dita e regjistrimit në klub të ri, gjimnastës/tit i llogariten pikët në klub të ri.

Neni 19.

Kur FGJK-ja pranon aplikimin/kërkesën e duhur për regjistrim me dokumentacionin e duhur, është e detyruar që ta bëjë regjistrimin më së voni deri me 30 Qershor gjegjësisht 31 Dhjetor të vitit aktual, d.m.th. më së largu brenda 7 ditëve nga muaji i ardhshëm kalendarik.

Neni 20.

Klubi/shoqata nuk mund të pezullojë një garues ose të filloj veprim disiplinor pas ditës së pranimit zyrtar të një aplikacioni/kërkese.

Neni 21.

Një garues i cili nuk ka marrë pjesë në gara për të paktën dy vite nga data e paraqitjes së fundit, kosiderohet së ka pushuar nga anëtarsimi në ish-klub/shoqatë.

21.1. Një garues i cili ka pushuar anëtarësimin në përputhje më dispozitat e paragrafit 1, të këtij neni, mund të regjistrohet për një klub/shoqatë të re.

Neni 22.

Një gjimnast/te i/e cili/a nuk është i/e regjistruar në FGJK, si një garues/ese mund lirisht të hyjë dhe të dalë nga anëtarësia e klubit/shoqatës gjatë gjithë vitit garues.

22.1. Klubi/shoqata, mund të refuzoj të lëshoj vendim për transfer të gjimnastit/tes, nëse palët nuk bien dakord, (klubet në mes veti), dhe nëse një klub/shoqatë pranon gjimnast/te, pa pëlqim të klubit tjetër, atëherë klubi që pranon gjimnastin/ten mund të ndëshkohet financiarisht, apo edhe me masë disiplinore.

22.2. Anëtarët e klubit/shoqatës (Kryetari, Sekretari, Trajneri) etj, në asnjë mënyrë nuk lejohen që të kontaktojnë, komunikojnë, bëjnë thirrje apo shfrytëzojnë trysni qoftë përmes email adresës, telefonit, apo edhe mënyrave tjera, tek gjimnastët/tet, për të kaluar prej një klubi në klub tjetër, nësë një gjë e tillë vërtetohet atëherë ndaj klubit do të merren masa disiplinore, kurse anëtari i klubit/shoqatës (Kryetari, Sekretari, Trajneri etj) do të gjobitet financiarisht.

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, House of Sport, Rr – Str. "Agim Ramadani", 10000 Prishtinë, email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com, tel:+38344145009

22.3. Nëse një gjimnast/te, për shkaqe të largësisë dhe kostos financiare (shkuarje/ardhje), dëshiron të kaloj në ndonjë klub tjetër që është më afër shtëpisë së tij/saj atëherë me pajtimin e palëve, (kërkesë me shkrim) mund të arrihet marrëveshja.

ANKESA

Neni 23.

Një garuesi që i është mohuar një kërkesë për lëshimin e vendimit, që kosiderohet se dispozitat e kësaj Rregullore janë shkelur në procedurë, mund të paraqesin ankësë me gjetjen e arsyetuar të parregullësisë në Bordin Ekzekutiv të FGJK-së.

23.1. Koha për paraqitjen e ankesës është 8 (tetë) ditë, nga pranimi i vendimit për refuzim të kërkesës.

Neni 24.

Bordi Ekzekutiv i FGJK-së, është i detyruar të marrë një vendim në bazë të ankesës brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes zyrtare.

24.1. Vendimi i Bordit Ekzekutiv është i formës së prerë.

Neni 25.

Nëse një garues konsideron se vendimi i Bordit Ekzekutiv ka shkelur dispozitat e kësaj rregullore, mund të aplikojë për mbrojtje në Organin e Arbitrazhit të Komitetit Olimpik të Kosovës, në pajtim me Rregullat për Arbitrazh të Komitetit Olimpik të Kosovës.

25.1. FGJK është detyruar të pranojë pjesëmarrjen në procedurën e arbitrazhit dhe të zbatojë, konkluzionet dhe rekomandimet e Arbitrazhit të KOK-ut.

E DREJTA NË PJESËMARRJE

Neni 26.

Një garues, anëtarësimi i të cilit pushon në një klub/shoqatë të mëparshme fillon të drejtën për t'u paraqitur për një klub/shoqatë të re, në të gjitha garat në përputhje më dispozitat e Nenit 16, të kësaj rregullore.

26.1. Klubet/shoqatat janë të detyruara të paraqesin garuesin në garë, librezën e garave, regjistrimin, në të gjitha garat para fillimit të tyre, si vërtetim i tyre për një shoqatë të caktuar.

26.2. Për klubet/shoqatat që duan ose nuk duan ta bëjnë, ata konsiderohen se nuk kanë regjistrime të vlefshme dhe garuesit e tyre nuk mund të garojnë në ato gara.

26.3. Vendimi për mos-transferim, për shkak të mosrespektimit të detyrimeve të përcaktuara të klubit/shoqatës, bëhet nga përsonai përgjegjës.

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, House of Sport, Rr – Str. "Agim Ramadani", 10000 Prishtinë, email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com, tel:+38344145009

E DREJTA E REGJISTRIMIT TË GJIMNASTËVE/EVE QË NUK JANË SHTETAS TË KOSOVËS

Neni 27.

Një shtetas i huaj mund të bëhet anëtar i klubit/shoqatës.

Neni 28.

Një garues – shtetas i huaj mund të regjistrohet në FGJK, me kusht që ai/ajo të ketë qëndrim të përhershmë ose të zgjatur në Republikën e Kosovës, dhe ka pëlqim me shkrim të Federatës Gjimnastikore të vendit nga ai/ajo vjen.

28.1. Garuesi – shtetas i huaj, i regjistruar në FGJK, mund të kryej apo përfaqësoj Federatën, një klub/shoqatë në të gjitha garat vendore dhe ndërkombëtare.

Neni 29.

Në rastin e transferimit të një shtetasi të huaj të regjistruar si garues në FGJK, nga një klub/shoqatë në tjetrën, do të zbatohen dispozitat e kësaj Rregulloreje.

IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 30.

Rregullorja është miratuar nga Bordi Ekzekutiv i FGJK-së, me datë 21/05/2026,

Shkumbin Maqastena
Kryetar i FGJK-së

Amir Tahiraga
Sekretar i përgjithshëm i FGJK-së

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, House of Sport, Rr – Str. "Agim Ramadani", 10000 Prishtinë, email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com, tel:+38344145009